

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË - DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZONI PENAL, Gjyqtari i vetëm gjykues, Gazmend Bahtiri, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Mihrie Sheholli, në çështjen penale kundër të akuzuarit H.M. nga fshati Ll., Komuna e P., për shkak të veprës penale ushtrimi arbitrar i të drejtave nga neni 326 par.1 të KPK-së, i akuzuar me aktakuzën e PPK në Prishtinë - tani Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, PP.nr.3920-5/2009 të datës 13.11.2009, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor publik në praninë e Prokurorit të Shtetit-Basri Morina, të dëmtuarit dhe të akuzuarit, me datë 16.01.2015, në të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli aktgjykimin, ndërsa përpilimi i aktgjykimit u bë konform neni 370 të KPPRK-së, me datë 30.01.2015.

A K T G J Y K I M

I akuzuari H. M., i biri i I. dhe nënës F. e vajzërisë H., i lindur më *data e lindjes...*, me vendbanim në fshatin Ll., Komuna e P., me nr. personal: *numër personal...*, ka të kryer shkollën e mesme, i martuar baba i tre (3) fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, me profesion këngëtar, më parë ka qenë i gjykuar me dënim me gjobë, nuk ka të dhëna se zhvillohet procedurë tjetër penale, Shqiptarë-Shtetas i Republikës së Kosovës.

Në kuptim të neni 363 par.1 nën par 1.3 të KPPRK-së

REFUZOHET AKTAKUZA

Sepse,

Me dt. 29.10.2009, rreth orës 11:00 në fshatin Llapashticë e Epërme të Podujevës, derisa firma "B.K." ka qenë duke bërë shtruarjen e asfaltit i pandehuri H. M. në pamundësi për të kaluar rrugën me veturën e tij, ushtron në mënyrë arbitrare të drejtat të cilat mendon se i takojnë në vend se ti drejtohet organit kompetent, ashtu që nga kompania e firmës "B. K." me targa të regjistrimit *numër i targave...*, merr librezën e qarkullimit dhe çelësat e kamionetës e cila kamionet ka qenë e vendosur në mes të asfaltit si bllokadë, dhe ka kërkuar nga tani i dëmtuari B. S. që të veprojnë në dëm të pasurisë së vet që në këmbim të gjërave të marrura t'i ja jep 300 euro.

Me këtë ka kryer veprën penale ushtrimi arbitrar i të drejtave nga neni 326 par 1 të KPK-së.

Shpenzimet e procedurës penale dhe paushalle bien në barrë te mjeteve buxhetore të gjykatës.

Kërkesë pasurore juridike nuk pati.

Gjykata duke vendosur sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 360 par 2 të KPPRK-së, beri rikualifikimin e veprës penale nga vepra penale detyrimi nga neni 267 të KPK-së, në vepër penale ushtrimi arbitrar i të drejtave nga neni 326 par.1 të KPK-së.

A r s y e t i m

PPK në Prishtinë - tani Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, ka ngrit aktakuzë PP.nr.3920-5/2009 të datës 13.11.2009, kundër të akuzuarit H.M. nga fshati Ll., Komuna e P., për shkak të veprës penale detyrimi, nga neni 267 par. 1 të KPK-së.

Lidhur me këtë çështje penale-juridike, gjykata mbajti shqyrtimet gjyqësore në praninë e prokurorit të Shtetit, të dëmtuarit dhe të akuzuarit.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit i akuzuari u deklarua i pa fajshëm për veprën penale për të cilën akuzohet.

Prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare deklaroi se e mbështet në tërësi aktakuzën, dhe kërkoj nga gjykata që i akuzuari të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

I dëmtuari në shqyrtimin gjyqësor deklaroi se nuk parashtron kërkesë pasurore-juridike.

Gjykata pas administrimit të provave dëgjimit të dëshmitarëve të propozuar nga prokuroria e shtetit dhe të akuzuarit, ka konstatuar se nuk plotësohen elementet e veprës penale detyrimi nga neni 267 par.1 të KPK-së.

Gjykata duke mos u detyruar me propozimin e prokurorit të shtetit lidhur me kualifikimin ligjor të veprës penale sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 360 par. 2 të KPPRK-së, beri rikualifikimin e veprës penale nga vepra penale detyrimi nga neni 267 par. 1 të KPK-së, në vepër penale ushtrimi arbitrar i të drejtave nga neni 326 par.1 të KPK-së, dhe ka vërtetuar se ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale për këtë vepër penale për të cilën është paraparë dënim me gjobë apo burgim deri në gjashtë muaj.

Në kuptim të nenit 90 par.1 nën par.6 të KPK-së, është përcaktuar se ndjekja penale nuk mund të ndërmerret nëse kanë kaluar dy (2)vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme deri në një (1) vit burgim ose dënim me gjobë, ndërsa në dispozitën e nenit 91 par.1 të KPK-së, është përcaktuar se afati i parashkrimit të ndjekjes penale fillon nga dita kur është kryer vepra penale, ndërsa në paragrafin 6 i këtij, është përcaktuar se ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit (ndalesa absolute mbi ndjekjen penale).

Meqenëse, nga dita e kryerjes së veprës penale të datës 29.10.2009,e gjerë me marrjen e këtij aktgjykimi kanë kaluar më tepër se pesë (5) vite, ashtu që parashkrimi absolut i ndjekjes penale ka arritur me dt.29.10.2013.

Aktgjykimi refuzues mbi parashkrimin absolut u muar në kuptim të nenit 363 par.1 nënë par. 1.3 të KPPRK-së, dhe nenit 6 të KEDNJ.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale mbështetet në nenin 454 par.1 të KPPRK-së.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 363 par.1 nën par 1.3 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZONI PENAL
P.nr.270/10,dt.30.01.2015**

**Sekretarja Juridike
Mihrie Sheholli**

**Gjyqtari i vetëm gjykues
Gazmend Bahtiri**

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë te drejtë të parashtrajnë ankesë në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate.